



Fakhrudin Razi: Komenti i Sures el-Kafirun

Description

Surja el-Kafirun (Mohuesit^[1])

1. “Thuaj: “O ju mohues!”

Duhet ditur se nga ky ajet kuranor mund të nxjerrim shumë dobi:

Dobia e parë: Ne e dimë që profeti ((a.s.)) është udhëzuar të jetë i butë dhe i sjellshëm në çdo aspekt, këtë gjë e konfirmon vet Zoti në shumë vende në Kuran: **“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.”** Al Imran:159, **“është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”** el-Teube:128, **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** el-Enbija:107, gjithashtu ai që udhëzuar të kishte sjellje shembullore teksa ju fliste njerëzve për Zotin **“dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!”** el-Nehal:125. Kjo sjellje strukturore e Muhamedit që e njohur tashmë, por kur ju drejtua me fjalët **“O ju mohues!”** që është shenjë e një ligjërimi të ashpër duhet thënë, ata të çuditur pyesin veten; si mund të shkojë përshtat një ligjërim kaq i ashpër me një sjellje kaq të butë?! Por përgjigjja e Muhamedit që e qartë, unë jam urdhëruar t’ju kumtoj vendimin e Zotit, pra kjo nuk është zgjedhja ime. Në këtë kontekst ne mund të dalim në përfundimin se Zoti dëshironte që Muhamedi t’ua raportonte mekasve këtë gjë.

Dobia e dytë: Me qenë se Zoti i kishte shpallur më herët Muhamedit **“Paralajmëroje farefisn tënd më të afërm”** (el-Shuara:214), dhe ne e dime tashmë se ai e donte jashtë mase farefisn, sepse këtë gjë e konfirmon vetë Zoti në Kuran **“Thuaju: “Për këtë nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi tjetër prej jush, përveç respektit për hir të farefisnisë (që kemi).”** (el-Shura:23), dhe kjo gjë e pengonte atë të ishte i ashpër në ligjërim, prandaj Zoti e urdhëroi të shprehet prerë dhe qartë, dhe i shpalli **“Thuaj”**.

Dobia e tretë: Zoti i shpalli Muhamedit **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij.”** el-Maide:67, pra e urdhëroi t'i kumtojë shoqërisë çdo gjë që Zoti do t'i shpallë. Prandaj kur Zoti shpalli **“Thuaj: “O ju mohues!”** profeti (a.s) ia përcolli këto fjalë toptan mekasve, sikur donte t'ju thoshte se Zoti më ka ngarkuar me misionin e lajmëtarit, pra unë jam ndërmjetësuesi i fjalëve të Tij në shoqëri, mes të cilave është edhe ky ajet **“Thuaj: “O ju mohues!”**, pra unë veç ju përcjell mesazhet e Tij.

Dobia e katërt: Pabesimtarët ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e një krijuesi që i krijoi dhe ju siguron risk, gjë që e konfirmon Zoti në Kuran: **“Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?”, me siguri që do të të thonë: “Allahu!”** (el-Lukman:25), dhe ne e dimë se shërbëtori është i detyruar ta durojë zotërinë e vet për gjëra që nuk do ta toleronte asnjë person tjetër, dhe në qoftë se Muhamedi do t'u thoshte mekasve **“O ju mohues”** do të ishte e arsyeshme që ata të mendonin se këto fjalë janë të Muhamedit, për rrjedhojë jo vetëm që nuk do ta toleronin, por ndoshta edhe mund ta lëndonin. Por sapo që ju tha **“Thuaj”** ata e kuptuan se ai po ju përcjell një mesazh të ashpër nga Krijuesi i qiejve dhe tokës, për rrjedhojë e toleruan dhe nuk ia morën për të madhe.

Dobia e pestë: Në arabisht **“Thuaj”** është një folje në mënyrën urdhërore, gjë që e bën të vetëkuptueshëm faktin se Muhamedi ((a.s.)) është i dërguari i Zotit, prandaj çdo herë që shpallej një urdhër **“Thuaj”** konsiderohej një qarkore e re e cila konfirmonte profecinë e tij, gjë që përforconte pozitën e lartë të tij. Sepse në qoftë se një mbret vendos t'ia delegojë kompetencat e veta njërit prej shërbëtorëve, sa herë që ai i dërgon një qarkore të re, për çdo muaj a për çdo vit, tregon se ai interesohet shumë për të, dhe se është i vendosur t'i përforcojë pozitën e tij në atë detyrë.

Dobia e gjashtë: Me qenë se pabesimtarët i propozuan Muhamedit ((a.s.)) ne do të adhurojmë Zotin tënd një vit ndërsa ti adhuro zotat tanë një vit tjetër, le të themi profeti Muhamed konsultohet me Zotin e tij dhe Ai shpalli: **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”** el-Kafirun: 1-2

Dobia e shtatë: Pabesimtarët u shprehën keq për Muhamedin, ndërsa Zoti i qortoi rëndë dhe u përgjigj **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”**, pra le të themi se Zoti thotë që, me qenë se Unë mora përsipër të të mbroj kur ata u shprehën keq për ty, përgjigju edhe ti për Mua tani që më lëndojnë me fjalë dhe më shoqërojnë ortak dhe **“Thuaj: “O ju mohues!”**

Dobia e tetë: Pabesimtarët të quajtën farësosur, dhe në qoftë se dëshiron të hakmerresh diskreditoji ata por tregohu i drejtë, vërju në dukje një gjë që ata e kanë, dhe **“Thuaj: “O ju mohues!”**. Diferenca është e dukshme në këtë përballje, ata të qortuan për diçka që s'varet nga ty, ndërsa ti për atë që e bëjnë me duart e tyre.

Dobia e nëntë: Ishte në mundësinë e Muhamedit ((a.s.)) të thoshte: **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**, por kjo shprehje do të linte hapësirë për dyshime, kështu që kurejshët mund të pyesin; këto janë fjalët e tua apo të Zotit tënd? Sepse ne na rezulton që Zoti yt thotë se unë nuk i adhuroj këto idhuj, dhe në fakt ne nuk po kërkojmë një gjë të tillë prej Zotit tënd por prej teje. Por në qoftë se këto fjalë janë të tuat, përse pra thua nuk i adhuroj idhujt tuaj pastaj pretendon që ky është një urdhër prej Zotit?! Por meqë Muhamedi u tha **“Thuaj”** kjo gjë eviton çdo dyshim, sepse jep të kuptohet se kërkesa për të mos adhuruar idhujt dhe të distancohet prej tyre, është urdhër i drejtpërdrejtë i Zotit.

Dobia e dhjetë: Zoti edhe po të shpallte **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni!”** profeti ((a.s.)) do ta përcillte këtë mesazh pa më të voglin dyshim, sepse ai nuk guxon ta tradhëtojë profecinë,

por meqë Zoti shpalli **“Thuaj”** kjo gjë e mbithekson detyrimin e kumtimit të shpalljes, gjë që tregon se çështja është shumë e rëndësishme. Sa kaq kuptojmë se urdhëri i prerë i Zotit **“Thuaj”** tregon se ajo që kërkuan ata prej Muhamedit që e neveritshme, veprim i shëmtuar dhe sjellje e pamoralshme.

Dobia e njëmbëdhjetë: Le të themi se Zoti parashton idenë se të qenurit i kujdesshëm është e nevojshme në kushte pasigurie dhe frike, por tani që të mbështetëm dhe të siguroam **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, dhe **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”**, mos u jep rëndësi dhe mos e mbaj mendjen tek ta, por **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni!”**.

Dobia e dymbëdhjetë: Komunikimi i Zotit me njeriun pa ndërmjetësues tregon se e çmon shumë, përndryshe një nga mënyrat se si Zoti i poshtëron pabesimtarët është se refuzon të komunikojë me ta. Prandaj nëse në ajetin në fjalë Zoti do të thoshte **“Ata janë mohues”** një mënyrë e tillë e të shprehurit konsiderohet vlerësim dhe nderim për ta, për sa kohë që është ligjërim verbal, ndërsa për aq kohë sa ekzaminon gjendjen e tyre prej mohuesish konsiderohet përçmim. Pra përçmimi kompensohet me nderimin. Por, me qenë se Zoti zgjodhi të mos komunikojë drejtpërdrejtë me ta por përmes Muhamedit që t’u thotë: **“Thuaj: “O ju mohues!”**, është një nderim që i bëhet Muhamedit, dhe përçmim për ta, sepse ata e meritojnë këtë gjë për shkak se ata e mohojnë Zotin. Në këtë kuptim, kështu nderohen miqt e Zotit dhe përçmohen armiqt e tij, më bukur se kaq nuk ka?!

Dobia e trembëdhjetë: Ne e dimë se Muhamedi ishte njëri prej tyre, dhe ishte i ndjeshëm dhe shfaqte keqardhje të thellë për ta, madje ata e dinin se ai ishte i sinqertë dhe e kishte zët gënjeshtër. Si një baba që ka dhembshuri të madhe për fëmijën e tij, që është shumë i ndershëm dhe larg gënjeshtres, ai e kritikon fëmijën e tij sepse e do, dhe në qoftë se fëmija është i arsyeshëm me siguri që do të dalë në përfundimin, se babai i tij me gjithë dashurinë që ka për të e kritikon veç për faktin se është i ndershëm dhe nuk mund ta mbajë të fshehur këtë gjë, ne këtë kuptim Allahu i thotë Muhamedit, thuaju atyre, o ju mohues, që ta dinë se edhe pse ke dhembshuri për ta dhe kurrë nuk ke qënijer ju vë në dukje një veti të keqe, ndoshta kjo do t’i nxisë ata të heqin dorë prej saj dhe të kenë kujdes.

Dobia e katërbëdhjetë: Ta lëndosh farefisnin dhe të sillesh egërsisht me të është më e rëndë se të sillesh njëjtë me njerëz të tjerë, sepse ti je pjesë e familjes dhe je rritur mes tyre, prandaj **“Thuaj: O ju mohues!”**, ndoshta këto fjalë rëndojnë mbi ta dhe nxiten të rishikojnë marrëdhënien e tyre me besimin dhe ndoshta heqin dorë prej mosbesimit.

Dobia e pesëmbëdhjetë: Pra le të themi se Zoti dëshiron të thotë, me siguri ju kam sqaruar në suren el-Asër: **“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** dhe në suren el-Keuther: **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, madje bëre vepra të mira për të përmbushur urdhërin tonë **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”** ka mbetur veç t’i këshilloni njëri-tjetrit të vërtetën e t’i këshilloni njëri-tjetrit durimin, që me fjalë dhe fakte t’i pengosh të adhurojnë dikë tjetër veç Zotit, prandaj **“Thuaj: “O ju mohues!”**.

Dobia e gjashtëmbëdhjetë: Zoti dëshiron të thotë; nëse të kujtohet o Muhamed tek e vonova shpalljen një kohë të shkurtër, pabesimtarët nxituan të thonë se Zoti e ka braktisur Muhamedin dhe e urren atë, gjë që të rëndoi pa masë, por Unë shpalla një Sure dhe u betova **“në shkëlqimin e paradites, dhe në natën kur terret e qetësohet, se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)!”**, në qoftë se nuk e përballoje dot braktisjen për një muaj, sepse zemra t’u pikëllua shumë derisa i shpalla të gjithë botës **“se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)!”** si mund të pranosh të

më braktisësh një muaj dhe të adhurosh idhujt e tyre?! Me qenë se unë shpalla një sure për ta mohuar këtë akuzë, atëherë edhe ti bëji thirrje atyre të heqin dorë nga kjo akuzë dhe **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**”.

Dobia e shtatëmbëdhjetë: Pasi mekasit kërkuan prej tij të adhurojë zotat e tyre një vit që të adhurojnë Zotin e tij një vit, ai heshti dhe nuk ju ktheu përgjigje, jo për faktin se ai mendoi për një moment që kërkesa e tyre qe e drejtë, përkundrazi ai ishte i vendosur të dekonstruktonte të pavërtetën e tyre, por çështja ishte si do t’u përgjigjej? Të shtronte argumentet logjike për pavlefshmërinë e kërkesës së tyre? T’ju shpallte luftë? Apo të kërkonte që Zoti të zbresë mbi ta ndonjë dënim? Mekasit e shfrytëzuan heshtjen e Muhamedit për të shpifur për të, demek Muhamedi po anon nga feja e tyre, prandaj Allahu sikur donte t’i thoshte se heshtja është gjëja e duhur por ka dhënë përshtypjen e gabuar, prandaj që ta korrigjosh këtë gjë duhet të deklamosh të vërtetën dhe **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**”.

Dobia e tetëmbëdhjetë: Kur Zoti i kërkoi Muhamedit ((a.s.)) ta lavdërojë në Natën e Miraxhit, këtë të fundit e pushtoi madhështia e pranisë hyjnore dhe tha: Nuk mund t’i numëroj dot lavdet për ty! Heshtja e profetit ((a.s.)) është shprehja e një sjellje prej fisniku. Është njësoj si të thuash; meqë heshte për shkak të madhësisë së pranisë hyjnore, atëherë mbaj qëndrim ndaj armiqve të Zotit dhe **“Thuaj: “O ju mohues!”**, që si heshtja ashtu edhe qëndrimi yt publik të jenë për Allahun.

Këtu kemi edhe një pohim tjetër, meqenëse prania e madhësisë hyjnore të rrëmbeu fjalët nga goja, atëherë shprehu qartë dhe prerë që fuqia e fjalëve të tua t’i bëjë të pafuqishëm ata të flasin.

Dobia e nëntëmbëdhjetë: Në qotë se Zoti do t’i shpallte Muhamedit (a.s.) mos adhuro çfarë adhurojnë ata, kjo nuk do ta detyronte atë të thoshte **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni!”**, por me që Zoti e urdhëroi të deklarojë verbalisht **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.”** kjo gjë e detyron atë të mos adhurojë çfarë ata adhurojnë, përndryshe do të duhej të përgënjeshtronte fjalët e veta.

Pra, përderisa Zoti kërkoi prej tij të thotë, **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.”**, kjo e detyron atë ta refuzojë kërkesën e tyre edhe me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë. Por nëse do të kërkonte prej tij të mos adhurojë çfarë ata adhurojnë kjo shprehje nënkupton veç refuzimin e adhurimit të idhujve në praktikë, por jo edhe mbajtjen e një qëndrimi refuzues si një akt verbal, sepse ne e dimë se një qëndrim refuzues i kompletuar përbëhet nga dy komponentë; refuzimi i praktikës dhe mbajtja e qëndrim. Në këtë kuptim fakti që Zoti i shpalli Muhamedit “Thuaj” dëshmon kërkesën për një qëndrim refuzues me intensitetin të lartë, prandaj në ajetin pasues thotë: **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.”**

Dobia e njëzet: Vënia në dukje e teuhidit dhe refuzimi i idhujve është xheneti i njohësve të Zotit dhe xhehenemi i idhujtarëve, pra fjala jote le të jetë xhenet për monoteistët dhe xhehenem për politeistët, prandaj **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e njëzet e një: Politeistët mekas tek kërkuan të bëjnë marrëveshje me Muhamedin që të adhurojnë Zotin e tij një vit, ndërsa ai të adhuronte Zotat e tyre një vit, Muhamedi heshti, me arsyetimin le të themi, se një përgjigje e drejtpërdrejtë nga ana e tij do t'i lëndonte ata dhe ndoshta nxiste urrejtje për Islamin në zemrat e tyre. Dhe në këtë ajet duket sikur Zoti vë në pikëpyetje heshtjen e tij, që në qoftë se vjen si aspiratë që ata të bëhen besimtarë, ti nuk ke nevojë për ta sepse **“Me të vërtetë Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, dhe në qoftë se vjen si pasojë e frikës, Ne ta larguam atë tek të shpallëm **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur.”**, pra mos e mbaj mendjen tek ata dhe mos kushto rëndësi fjalëve të tyre, por **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuron!”**.

Dobia e njëzet e dy: Harrove vallë o Muhamed se Unë hakun tënd e vura në rend të parë kur shpalla **“Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve”** el-Bejine:1, i rendita të parët ithtarët e librit edhe pse si ata ashtu edhe politeistët janë mohues, sepse ithtarët e librit shpifën për ty ndërsa politeistët për Mua, dhe duke kritikuar ithtarët e librit para politeistëve të dhashë ty përparësi. Edhe ti u solle njëjtë tek të thyen dhëmbin në beteje the **“O Zot udhëzoje popullin tim. Madje edhe gjatë betejës së Hendekut kur nuk munde të faleshe dot the: O Zot mbushi barqet e tyre me zjarr!”** Edhe tani sillu njëjtë, frikësohesh apo jo prej tyre, më jep mua përparësi, dhe shprehe haptazi refuzimin tënd për propozimin e tyre dhe **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuron!”**

Dobia e njëzet e tre: Sikur Zoti dëshiron të thotë; ngjarja e bashkëshortes së Zejdrit është e parëndësishme në raport me këtë ngjarje, megjithatë Unë nuk u kënaqa që ti fshihje në vetvete diçka dhe nuk e bëre publike atë, përkundrazi si kritikë ndaj teje Unë shpalla **“Në të vërtetë, ti po fsheh në vetvete atë që Allahu do ta nxjerrë në shesh dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kur më e drejtë është t'i frikësohesh Allahut.”** el-Ahzab:37, dhe në qoftë se për një ngjarje të rëndomtë Unë nuk qesh i kënaqur derisa ta bëje publik lajmin, dhe të mos mendoje për fjalët e njerëzve, si mund të kënaqem në këtë rast, duke e ditur që kjo është një çështje shumë e rrezikshme në qoftë se marrim në konsideratë heshtjen, prandaj qartazi dhe prerë thuaj **“O ju mosbesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuron!”**

Dobia e njëzet e katër: Nuk të shpalla ty O Muhamed **“Sikur të donim Ne, do të dërgonim në çdo qytet paralajmërues”** el-Furkan:51, megjithatë Unë mbajta anën tëndë që të bëhet zemra mal, dhe i shpalla të gjithë botës se Unë nuk do ta ndaj profecinë e Muhamedit me asnjë profet tjetër sepse **“ai është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve”** el-Ahzab:40. Dhe ti e di që është e pamundur të ekzisojë një i adhuruar tjetër krahas meje, në këtë kuptim detyrohesh më shumë se çdo kush tjetër ta refuzosh idhujtarinë dhe t'i shpallësh qartë dhe prerë njerëzimit **“Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuron!”**.

Dobia e njëzet e pestë: Sikur Zoti gjithashtu dëshiron të thotë; Populli yt dëshiron të të joshë me një ofertë; të adhurojnë Zotin tënd që të adhurosh zotat e tyre, ndërsa ti heshte dhe nuk mbajte qëndrim, por Unë në fakt besnikërinë e atyre që u betuan e konsiderova si besnikëri ndaj Meje kur thashë: **“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut.”** el-Fet'h:10, madje pasimin tënd e konsiderova bindje ndaj Meje tek thashë: **“Thuaj: “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë”** Al Imran:31, pastaj i shpalla të gjithë botës **“Allahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim ndaj idhujtarëve”** el-Teube:4, pra edhe ti bëja të qartë atyre qëndrimin tënd dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuron!”**.

Dobia e njëzet e gjashtë: Le të themi se Zoti i Madhëruar dëshiron të thotë: A nuk jam treguar më i

sjellshëm me ty se babai me fëmijën?! Prandaj është më e ndershme të përballësh me mospasjen dhe urinë pranë babait sesa të ngopesh pranë një të huaji. Dhe në fakt ata janë të uritur, sepse idhujt e tyre janë të vdekur, pa jetë, pa atribut, ndërsa ata të varfër për dije dhe të zhveshur nga devocioni?! Ti më ke provuar Mua. Nuk të gjeta jetim, të paditur dhe pa përkrahje?! Nuk ta hapëm Ne ty kraharorin?! Nuk të përkraha me Sidikun një thesar më vete, me prestigjin e Farukut, me ndihmën e Osmanit dhe diturinë e Aliut? Nuk i pengova të zotët e elefantit të cilët u përpoqën të shkatërrojnë qytetin tënd?! Nuk i sigurova paraardhësit e tu në udhëtimet e tyre tregëtare gjatë dimrit dhe verës?! Nuk të dhashë të mira pa fund?! Nuk të garantova se kundërshtari yt është farësosur?! Nuk qe gjyshi yt ai që tha: **“përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?”** Merjem:42, pasi i dëmtoi ato?! Pra edhe ti shfaqe hapur refuzimin tënd për ta dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e njëzet e shtatë: Zoti le të themi dëshiron gjithashtu të thotë; Nuk të shpalla **“përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër!”** el-Bekare:200, madje në qoftë se dikush do të pretendonte se ti je fëmija e dikujt tjetër, me siguri që do të zemërohesh dhe do ta përbuzje atë pretendim duke arsyetuar se ke prejardhje fisnikësh dhe nuk je një fëmijë jashtëkurore. E pra, në qoftë se për këtë akuzë nuk hesht, si mund të heshtësh për akuzën e politeistëve?! Prandaj intensifikoje refuzimin tënd për idhujt e tyre, dhe shprehu prerë e thuaj: **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e njëzet e tetë: Sikur Zoti i Madhëruar dëshiron të thotë gjithashtu o Muhamed nuk të shpalla ajetin **“Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?! A nuk po merrni vesh?”** el-Enbija:17, dhe gjykova se kush e barazon Krijuesin që adhurohet me një idhull pa shpirt nuk mund të jetë i shëndoshë mendërisht por i çmendur, pastaj u betova tek thashë **“NÛn. Beto hem për penën dhe për atë që shkruajnë, se ti (o Muhamed), falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë.”** el-Kalem:1-2, edhe pse pabesimtarët thonin se ti je i marrë, prandaj deklaroi haptazi refuzimin për këtë shpifje, sepse vërtetonte se Unë jam i pastër dhe pa të meta, dhe se edhe ti nuk je i çmendur, dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e njëzet e nëntë: Pabesimtarët i konsideronin idhujt e tyre Zota, megjithatë ngjashmëria e emertimeve nuk do të thotë barazi në tipare dhe veti. Vërtet burri dhe gruaja kanë të përbashkëta sepse janë qenie njerëzore por kujdestar është burri sepse ai është më i zoti për këtë punë, sepse kush është më i aftë dhe i zoti meriton të jetë kujdestar, përndryshe si mund të bëhet kujdestar kush nuk është i zoti të menaxhojë?! Mund të shtoj edhe diçka këtu. Në qoftë se një grua e pretendonjë dy burra edhe sikur ata të bëjnë marrëveshje, marrëveshja është e pavlefshme, edhe në qoftë se secili prej tyre paraqet fakte që provojnë se ajo është grua e tij, merret vendim kundra të dyve. Madje as robëresha nuk mund të jetë në shërbim të dy pronarëve njëkohësisht. Dhe në qoftë se një femër nuk mund të jetë grua e dy burrave njëkohësisht, dhe as një robëreshë e dy pronarëve, si është e mundur që një adhurues të ketë dy Zota?! Kush pranon se dy burra mund të bëjnë marrëveshje të jetojë secili prej tyre me të njëjtën grua një muaj njëri dhe një muaj tjetri, ka bërë kufër. Edhe kush pranon që kjo gjë mund të funksionojë edhe kur bëhet fjalë për Zotin dhe idhujt ka bërë kufër gjithashtu. Pra sikur Zoti dëshiron t'i thotë Muhamedit (a.s.) ky pretendim është i neveritshëm, prandaj refuzoi qartë dhe prerë, dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e tridhjetë: Sikur Zoti i Madhëruar po thotë: Harrove se Unë i dhashë bashkëshorteve të tua mundësinë të zgjedhin tek shpalla: **“O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: “Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t’ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t’ju lëshoj si është më mirë. Por, nëse dëshironi Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, dijeni se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira.”**

el-Ahzab: 28-29, dhe u frikësive nëse Aisheja mund të zgjidhte jetën e kësaj bote dhe i kërkonte të mos merrte vendim pa u konsultuar me prindërit e saj, por ajo u përgjigj, për këtë gjë të konsultohem me prindërit e mi?!, -përkundrazi unë zgjedh Allahun, të dërguarin e Tij dhe Botën Tjetër. Pra ajo që ka më pak mend nuk reshti së kundërshtuari çfarë nuk më kënaq Mua, mos vallë do të reshtësh ti së kundërshtuari çfarë më zemëron dhe thyen urdhërin Tim, edhe pse ti e di që Unë jam i Gjithëpushtetshmi i qiejve dhe i tokës?! prandaj **“Thuaj “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e tridhjetë e një: I Lartësuarit le të themi dëshiron t'i thotë Muhamedit, nuk je ti ai që tha Kush beson Allahun dhe ditën e fundit të mos qëndrojë në vende të dyshimta! Madje edhe njerëzit e ditur i porositnin nxënësit e tyre të mos frikësohen prej pushtetarëve, sepse kjo sjellje i çon njerëzit në një prej dy gabimeve; Ose do të mendojnë se pushtetari është fetar i devotshëm sepse shoqërohet me një dijetar të devotshëm, ose do të mendojnë se edhe ti je i shturur njësoj si ai, dhe që të dyja janë gabim. Dhe në qoftë se pra të evitosh një vend të dyshimtë është e domosdoshme, heshtja jote o Muhamed të vë në bankën e të akuzuarve si një person që është i kënaqur me këtë propozim, sidomos tani që shejtani inspiroi vargjet e lejlekëve tek lexoje Kuran: “Këta janë lejlekët e madhërishëm – Prej tyre veç ndërmjetësim shpresojmë, prandaj mohojë këtë akuzë dhe **“Thuaj “O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**”.

Dobia e tridhjetë e dy: Njeriu ka dy detyrime: një ndaj personit që kujdeset për të, që mund të jetë zotëriu i tij, dhe një për personin që kujdeset, që është fëmija i tij. Në kemi rënë dakord që t'i shërbesh zotërisë ka prioritet ndaj edukimit të fëmijës. Dhe në qoftë se është kështu, atëherë detyrimi ndaj kujdestarit të vërtetë ka edhe më shumë prioritet. Tregohet se Aliu i kërkoi Muhamedit (a.s.) të martohet me vajzën e Ebu Xhehlit gjë që e zemëroi shumë dhe i tha: Nuk të lejoj, nuk të lejoj, nuk të lejoj! Fatimeja është pjesë e imja, çfarë e lëndon atë më lëndon edhe mua, çfarë e gëzon atë më gëzon edhe mua. Allahu nuk i bën bashkë vajzën e të dashmit të Zotit me vajzën e armikut të Zotit. Pra sikur Zoti dëshiron të thotë se në këtë rast ti mbajte qëndrim madje shumë të fortë duke treguar përkujdesje për fëmijën tënd, këtë qëndrim duhet ta mbash me prioritet edhe më të madh kur kurejshët të bën propozim, për të rujtatur interesin e Zotit tënd, prandaj thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**. Unë nuk do ta bashkoj kurrë në zemrën e një personi, hem dashurinë për mikun hem dashurinë për armikun.

Dobia e tridhjetë e tretë: Të kujtohet kur i the Umerit, pashë një kështjellë në Xhenet dhe pyeta, e kujt është kjo? Një djaloshi kurejshit, -më thanë. E kush është ky djalosh? -pyeta unë. Umeri, thanë ata. Më erdhi ndërmend xhelozia e Umerit dhe u largova nga ajo kështjellë. Si mund të kemi xhelozia për ty, o i dërguari i Allahut, -tha Umeri?! Pra sikur Zoti dëshiron të thotë, hoqe dorë nga ajo kështjelle sepse u frikësive prej xhelozisë së Umerit, po prej xhelozisë sime nuk druhash, sepse ndoshta zemrën tënde e pushtojnë zota të tjerë veç meje?! Pra siç refuzove të futësh në kështjellën e Umerit, refuzo të futet në zemrën tënde zot tjetër veç meje, prandaj thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e tridhjetë e katërt: Unë jam përkujdesur për ty më shumë se nëna jote. Nuk u kujdesa për ty?! Nuk të krijova?! Nuk të dhashë të mira pa fund?! Nuk të fala jetën, të dhashë fuqi, arsye të fortë, të udhëzoja dhe të bëra të suksesshëm?! Teksa ishe fëmijë i paformuar u mësove me përkujdesjen e nënës tënde, e nëse një grua e më e bukur, më e hijshme dhe e sjellshme se nëna jote do të kërkonte të kujdesej për ty, ti do ta refuzoje dhe do të qaje. Nëse ajo do të ofronte të pije qumësht prej gjirit të saj do ta vendosje dorën mbi gojë dhe do ta refuzoje, nuk dua asnjë përveç nënës sime sepse ajo është kujdesur për mua, do të thojë me siguri. Në këtë rast duhet të mbash edhe më shumë qëndrim

sepse Zoti është kujdesur për ty më shumë se çdokush tjetër prandaj distancohu prej tyre dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e tridhjetë e pestë: Begatia e ushqimit nuk krahasohet me begatinë e intelektit dhe profecisë, megjithatë ti e di se delja dhe qeni nuk e harrojnë dorën që i ka ushqyer dhe nuk shprehin mirënjohje për asnjë veçsaj, e në qoftë se kafsha është mirënjohëse, si është e mundur që një njeri i arsyeshëm të harrojë begatinë e krijimit, dhe për më tepër krijesa më e mirë e njerëzimit, prandaj thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

[...]

Dobia e tridhjetë e shtatë: Pabesimtarët për shkak të marrëzisë së tyre menduan se shumë zota është njëjtë si shumë pasuri, të pasuron më shumë, por kjo gjë është e pavërtetë, përkundrazi shumë zota është njëjtë si të kesh shumë fëmijë, shtohen edhe më shumë nevojat. Prandaj thuaju atyre o Muhamed, unë kam një Zot, falem për të natën dhe agjëroj ditën, megjithatë nuk arrij të kompensoj një grimcë të begative që më ka dhuruar Ai, e si mund të jem korrekt me shumë Zota, prandaj thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e tridhjetë e tetë: Kur Xhibrili iu shfaq Merjemes **“Ajo i tha: “Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut.”** Merjem:18, pra ajo kërkoi nga Zoti ta mbrojë që të mos mbështetet tek Xhibrili por veç tek Zoti, do t’ia lejoje vetes të anoje nga idhujt edhe pse je një burrë me personalitet?! Prandaj **“Thuaj: O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e tridhjetë e nëntë: Nuk ekziston në botën e gjallesave asnjë gjallesë e vogël qoftë sa atomi të mos dëshmojë për njerëzit e arsyeshëm ekzistencën e Zotit, ndërsa personat që ju bëjnë të njohur njerëzve vendimet e Zotit janë profetët, dhe meqenëse çdo insekt dëshmon për krijuesin e saj, Zoti ka thënë: **“Allahu nuk ngurron të japë shembull mushkonjën ose diçka më të madhe se ajo.”** el-Bekare:26, sepse edhe mushkonja për karakteristikat e saj fizike është dëshmi e ekzistencës së Zotit të plotfuqishëm. Struktura e saj karakteristike dhe tiparet e saj dëshmojnë për kapacitetin e jashtëzakonshëm të Zotit dhe vullnetin e tij absolut. Sikur Zoti dëshiron të thotë; si mund të turpërohesh për një krijim të tillë?! Tregohet se kalifi i muslimanëve Umeri shkoi në treg, bleu një plendës dhe e hodhi mbi shpinë dhe mori të shkojë në shtëpi. Aliu e pa nga larg dhe mori t’i shmanget që të mos e shikonte Umeri, por ai iu afrua dhe i tha: “Përse po më shmangesh? Kisha frikë mos turpërohesh, -ia ktheu Aliu. Të kem turp se po mbaj ushqimin tim?! -iu përgjigj Umeri i çuditur.

Pra, le të themi se Zoti dëshiron të thotë, në qoftë se Umeri nuk turpërohej se po mbante një plendës që i duhej për t'u u shqyer, duhet të kem turp Unë pse po përmend një mushkonjë që ushqen besimin tënd?! Edhë Nemrudi pretendoi se është Zot, por mushkonja nuk e pranoi këtë gjë dhe i tregoi se çfarë është ai në të vërtetë. Ndërsa pabesimtarët të ftuan në politeizëm, nuk do t'ia përplasësh syve dhe të mbash qëndrim ndaj tyre duke thënë **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**. Edhe Xhibrili ia mbushi gojën me rërë Faraonit tek pretendoi hyjninë. Në qoftë se ndjehesh i dobët, më i dobët se mushkonja e Nemrudit nuk je, dhe nëse ndjehesh i fortë nuk je më i fortë se Xhibrili, prandaj mbaj qëndrim ndaj tyre dhe thuaj **“O ju mohues! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**

Dobia e dyzet. Le të themi se Zoti dëshiron t'i thotë Muhamedit, dëshmo me gjuhën tënde **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”** pastaj lërë hua në dorën time, sepse Unë do ta kompensoj huanë në mënyrën më të mirë. Nuk e ke vënë re se Unë nuk e pranoj dëshminë e një të krishteri derisa të distancohet nga feja e vet, dhe përderisa unë e kam detyruar çdo njeri të distancohet nga çdo besim që bi në kundërshtim me fenë tënde që të bëhet pjesë e saj, edhe ti detyroje veten të mbajë qëndrim ndaj çdo zoti të rremë që adhurohet krahas meje dhe thuaj **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**.

Dobia e dyzet e një: Musai (a.s.) ishte i ashpër për nga natyra dhe Zoti kur e dërgoi tek Faraoni në cilësinë e profetit e porositi: **“Flitini atij fjalë të buta”** Taha: 44, ndërsa Muhamedi (a.s.) kur shpalli profecinë Zoti e urdhëroi të tregohet i ashpër në ligjërim, si një përkujtim për mekasit se ai është jashtëzakonisht i mëshirshëm, prandaj Zoti e porositi t'u thotë: **“Thuaj: “O ju mosbesimtarë!”**

Pas gjithë çfarë thashë deri më tani, më duhet të theksoj se ky ajet përfshin disa çështje:

Çështja e parë: Për pasthirmën – ?? ?????(“O ju”), kam folur edhe më herët, por do të shtoj edhe diçka këtu. Transmetohet se Aliu ka thënë: ?? – *Ja* – është thirrja e njeriut, ?? – *Eju* është thirrja e zemrës, ndërsa ?? – *Ha* është thirrja e shpirtit. Ka edhe një interpretim tjetër që konsideron se; ?? – *Ja* është thirrje në mungesë, ?? – *Eju* është thirrje në prani, ndërsa ?? – *Ha* shërben për të tërhequr vëmendje. Pra le të themi se kuptimi është ky; në qoftë se të thërras tri herë dhe nuk më përgjigjesh qoftë edhe një herë të vetme është kjo shprehje e padijes së fshehur.

Disa të tjerë mendojnë se Allahu pasthirmën ?? – *Ja* – O që përcakton një person që është larg, e bashkoi me përemrin ?? – *Eju* – ju që përcakton një person që është afër, për të thënë se marrëdhënia jote me Mua dhe largimi prej Meje shkakton distancim, por mëshira dhe begatia Ime qenë arsye për të të afruar pranë, **“Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet”** Kaf:16. Zoti rendit të parën pasthirmën e cila shpreh distancim pastaj përemrin që është shprehje e afërsisë sikur dëshiron të thotë se dështimi është prej teje ndërsa sukcesi prej meje. Gjithashtu mund të them se pasthirmë ?? – ja (“O”) shpreh distancim që në këtë rast përngjan me vdekjen, ndërsa përemri ?? – *Eju* – ju shpreh afritet që përngjan me jetën, në këtë kuptim kur ato përngjiten krijohet një gjëndje e ndërmjetme mes jetës dhe vdekjes, dhe një gjëndje e tillë është edhe gjumi le të themi, sepse njeriu që është në gjumë duhet ta cysësh të zgjohet, kështu që pjezësa ?? – ha shërben pikërisht për këtë gjë, prandaj dhe vjen e fundit në renditjen e kësaj pasthirmë të përbërë në këtë ajet.

Çështja e dytë: Tregohet se shkak i shpalljes së kësaj sureje qe el-Velid ibn Mugire, el-As ibn Vail, el-Esved ibn Abdulmutalib dhe Umeje ibn Halef të cilët në këmbim të adhurimit të Allahut një vit i kërkuan profetit (a.s.) të adhuronte zotat e tyre një vit, kështu do të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe do ta shuajm armiqësinë mes nesh, -thanë ata, dhe në qoftë se ajo që beson ti është e drejtë do të përfitojmë prej saj, por në qoftë se është e drejtë ajo që besojmë ne do të përfitosh edhe ti prej saj. Por

Zoti shpalli suren el-Kafirun, pastaj ajetin 64 në suren el-Zumer **“Thua ju atyre: “Vallë, ju po më urdhëroni që të adhuroj dikë tjetër, përveç Allahut, o të paditur?!”**. Po të vëmë re një herë i konsideron të paditur dhe një herë tjetër mohues, dhe në fakt injorancën mund të krahasoj me një pemë, frutat e së cilës janë mohimi. Profeti (a.s.) ia komunikoi me zë shpalljen ndërsa ata e ofenduan dhe u dëshpëruan.

Dhe tani është momenti të bëj disa pyetje:

Pyetja e parë: Përse në këtë sure Zoti i quan mohues ndërsa në suren tjetër injorantë?

Sepse el-Kafirun zbriti si përgjigje e drejtpërdrejtë për ta, dhe si e tillë është e arsyeshme të përmbajë një përgjigje të ashpër, dhe në fakt nuk ka term më të keq dhe më të neveritshëm se termi qafir, madje njerëzit e dinë se ky term është i ngarkuar me konotacion negative, ndërsa termi injorant i përdorur me kufizime nuk është i tillë, prandaj profeti (a.s.) thotë për shkencën e gjenealogjisë “Dije e padobishme dhe injorancë e padëmshme.”

Pyetja e dytë: Përse në suren el-Tahrim Allahu thotë: **“O ju që mohuat”** pa e shoqëruar me foljen thuj, ndryshe nga verseti në fjalë në të cilën përveç se përdoret folja thuj në mënyrën urdhërore, kryefjala shprehet gjithashtu me emër?

Përgjigja mund të ishte kjo: Ajeti në suren el-Tahrim flet për ngjarjet e Botës Tjetër, atje profeti nuk do të jetë më profet, prandaj ligjërimi është i drejtpërdrejtë sepse nuk ka nevojë për ndërmjetësim, njerëzit janë të gjithë të nënshtruar sepse nuk mund të ketë mohues atë ditë, prandaj folja është përdorur në kohën e kryer, ndryshe është çështja këtu, sepse ata vazhdojnë të jenë mohues dhe profeti vazhdon të jetë i dërguari i Zotit tek ta, prandaj Zoti tha: **“Thuj: “O ju mohues!”**

Pyetja e tretë: Ajeti kuranor **“Thuj: “O ju mohues!”** i përfshin të gjithë mohuesit apo një pjesë të tyre?

Mendoj se ky ajet **“Thuj: “O ju mohues!”** nuk mund të jetë ligjërim gjithëpërfshirës, sepse mes tyre me siguri ekzistonin njerëz të cilët adhuronin Allahun, le të themi hebrenjtë dhe të krishterët, kështu që nuk do të ishte e drejtë t’u drejtohej atyre **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**, dhe as të shprehej **“dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”**, sepse mes mohuesve kishte njerëz të cilët besuan dhe adhuruan Allahun. Por mund të themi se ky ajet kuranor është ligjërim verbal dedikuar një grupi të caktuar njerëzish, më konkretisht atyre që i paraqitën ofertën; adhurojmë Zotin tënd një vit të adhurosh zotat tanë një vit. Pra, në qoftë se ajetin në fjalë do ta konsiderojmë ligjërim gjithëpërfshirës futet aty edhe ligjërimi i posaçëm, por nëse do ta konsiderojmë ligjërim të posaçëm verbal nuk jemi të detyruar ta pranojmë këtë gjë, prandaj interpretimi i ajetit në këtë kontekst është më i arsyeshëm.

“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni, dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni, dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!” el-Kafirun:2-5.

Këtu mund të trajtojmë disa çështje:

E para: Dijetarët ofrojnë dy interpretime në lidhje me këtë ajet, një grup pretendon se ka përsëritje ajetesh, ndërsa pala tjetër pretendon se nuk ka.

Argumentet e palës së parë:

E para: Ajeti i parë flet për të ardhmen ndërsa ajeti i dytë për të tashmen, pra fjala e Allahut **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”** do të thotë që unë nuk do të bëj në të ardhmen atë që kërkoni ju prej meje, pra nuk do t'i adhuroj zotat tuaj, po edhe ju nuk do ta bëni një gjë të tillë, pra as ju nuk do ta adhuroni Zotin tim, kjo tregon se edhe në të tashmen unë nuk do t'i adhuroj zotat tuaj, por edhe ju nuk do të jeni adhurues të zotit tim.

E dyta: Mund të shprehemi edhe ndryshe, dhe le të themi se ajeti i parë flet për kohën e tashme dhe ajeti tjetër për të ardhmen, sepse në qoftë se unë them: unë e vras Zejdin^[2], me siguri që kjo nënkupton kohën e ardhme.

E treta: Disa dijetarë arsyetojnë se që të dy ajetet vlejné për të shprehur si kohën e tashme ashtu edhe të ardhmen, por ne e përcaktojmë njërin prej tyre në kohën e tashme ndërsa tjetrin në kohën e ardhme që të shmangim përsëritjen. Dhe në qoftë se do të thoshim se ajeti i parë shprehet në kohën e tashme ndërsa i dyti në kohën e ardhme kjo është shumë e arsyeshme sepse kështu renditet edhe koha, por në qoftë se do të pranohet se ajeti i parë flet shprehet në kohën e ardhme atëherë kjo do të ishte e arsyeshme gjithashtu sepse ata këtë gjë kërkuan prej tij dhe ai mori t'u përgjigjet sipas rëndësisë.

Po në qoftë se bëjmë pyetjen çfarë dobie ka të pranohet që ajeti flet për kohën e tashme ndërkohë që ne e dimë se profeti nuk i adhuronte idhujt, ndërsa në anën tjetër politeistët adhuronin edhe Allahun ndonjëherë? Në planin personal, ky pohim shërben për të shmangur çdo iluzion që mund të ketë dikush për profetin (a.s.), pra faktin se profeti (a.s.) adhuronte ndonjë idhull fshehurazi, sepse frikësohej prej tij ose shpresonte tek ai, ndërsa mohimi i mundësisë që ata adhurojnë Zotin vjen si pohim i faktit se vepra e një mohuesi nuk konsiderohet fare adhurim, pra zhvlerësohet totalisht.

E katërta: Ky është në fakt mendimi i Ebu Muslimit i cili pretendon se dy ajetet e para marrin në shqyrtim Zotin, pra të adhurueshmin, njësoj sikur të thotë që unë nuk i adhuroj idhujt dhe as ju Allahun. Ndërsa ajetet e dyta marrin në shqyrtim adhurimin, pra veprën e njeriut, njësoj sikur të thotë që unë nuk adhuroj si ju sepse adhurimi juaj bazohet në politeizëm, po as ju nuk adhuroni si unë, sepse adhurimi im bazohet në dije të sigurt. Dhe në qoftë se pretendoni se adhuroni Zotin tim, kjo është e pavërtetë sepse adhurimi është një veprim që përcakton vetë Zoti dhe urdhëron, ndërsa ajo që veproni ju është një veprim që Zoti e ndalon.

E pesta: Mund të supozojmë se ajeti i parë shpreh refuzim për propozimin e tyre, ndërsa ajeti i dytë merr në shqyrtim të gjitha mundësitë dhe i refuzon të gjitha pastaj. Njësoj sikur të thotë, unë nuk e adhuroj atë që adhuroni ju me shpresën që të adhuroni veç Allahun, as ju ??nuk e adhuroni Zotin, me shpresën që unë do t'i adhuroj idhujt tuaj. Pastaj përsërit se unë nuk adhuroj idhujt tuaj për asnjë

arsye dhe përfitim të mundshëm, dhe edhe ju nuk e adhuroni Zotin tim për asnjë arsyë dhe përfitim. Njësoj si të ftosh dikë të bëhet pjesë e një zullumi me qëllim që të përfitojë, ndërsa ai refuzon të bëhet pjesë e zullumit për këtë qëllim, madje refuzon të bëhet pjesë e zullumit për çfarë do arsye.

Argumentet e palës së dytë:

E para: Përsëritja shërben si afirmim, dhe sa herë që të jetë e nevojshme aq më e dobishme është përsëritja, dhe në fakt nuk ka vend që ka nevojë për përsëritje si rasti në fjalë, sepse mohuesit ia përsëritën disa herë këtë kërkesë, dhe heshtja nga ana e tij u dha përshtypjen se ndoshta ai u josh nga oferta e tyre, në këtë kuptim që e nevojshme të konfirmohej refuzimi duke e përsëritur atë.

E dyta: Kurani zbriste pjesë-pjesë, ajet pas ajeti, në përgjigje të dyshimeve dhe kërkesave të tyre. Politeistët kërkuan nga profeti të pranojë disa prej zotrave të tyre që edhe ata të besonin Zotin e tij, ndërsa Allahu shpalli ajetet **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni, dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”**. Pastaj politeistët sërish i bëjnë një ofertë tjetër; adhuroji zotat tanë një muaj të adhurojmë Zotin tënd një muaj, ndërsa Allahu shpalli ajetet **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni, dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”**. Në këtë kuptim, përderisa mundësia që ata të bënin oferta të tilla ishte permanente atëherë edhe përsëritja e përgjigjes nuk është fare e paarsyeshme.

E treta: Politeistët e përsëritën dy herë kërkesën e tyre. Adhuroji zotat tanë një muaj të adhurojmë Zotin tënd një muaj, ose adhuroji zotat tanë një vit të adhurojmë Zotin tënd një vit, prandaj përgjigja që e përsëritur në përputhje me kërkesën e tyre. Kjo është një lloj ironie në fakt, sepse kushdo që përsërit të njëjtën kërkesë për një qëllim të keq, do ta shpërblesh duke e refuzuar në të njëjtën mënyrë, me mospërfillje dhe përçmim.

Çështja e dytë: Ka një pikëpyetje në këtë ajet, dhe ajo lidhet me përemrin pyetës ?? – ma – çfarë, që në këtë kontekst përdoret si përemër lidhor dhe i referohet qënieve të paarsyeshme, dhe në qoftë se supuzojmë se idhujt e tyre ishin të tillë, përemri në fjalë është fiks për ta, por ne e dimë se i adhurueshmi i Muhamedit është i dituri absolut, në këtë kuptim si mund të shprehet ai **“dhe ju nuk jeni adhurues të çfarë unë adhuroj”?! Mund të jap katër përgjigje për këtë çështje:**

E para: Le të themi se është shprehur për atributet e subjektit që do të adhurohet, pra unë nuk adhuroj çfarë është i pavërtetë, ndërsa ju nuk adhuroni çfarë është i vërtetë.

E dyta: Unë nuk adhuroj si adhurimi juaj, dhe as ju nuk do të adhuroni siç adhuroj unë, të njëjtën gjë ia konfirmoi edhe në kohën e tashme.

E treta: Mund ta konsiderojmë përemrin e pacaktuar?? – *ma* si përemër lidhor, pra me kuptimin ????? – *eledhi* – i cili, në këtë kontekst kuptimi i ajetit do të ishte i drejtë.

E katërta: Në logjikën e ajetit **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”** Zoti shpalli edhe ajetin në vijim, njësoj si ky ajet kuranor **“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe”** el-Shura:40.

Çështja e tretë: Dijetarë të medhhebit xheberi[3] pretendojnë se Zoti në këtë sure mbështet bindjen e tyre dy herë përmes ajetit **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**, sepse një lajm i vërtetë që konfirmon

mosekzistencën e një subjekti bie në kundërshtim në qoftë se ai ekziston. Në këtë kuptim detyrimi për të adhuruar Zotin krahas një fakti të vërtetë që mohon këtë detyrim është përpjekje për të bërë bashkë dy të kundërta.

Megjithatë kanë mbetur edhe disa pyetje të tjera lidhur me këtë ajet:

E para: Nuk është më e arsyeshme të përmendet arsyeja se përse një adhurim dedikuar dikujt tjetër veç Zotit është i shëmtuar në vend të përsëritjes së ajetit?

Mund të them se përsëritja dhe konfirmimi është më efikas në disa raste se sjellja e argumentit, ose për arsye se personi përballë është i trashë dhe kupton veç duke ia përsëritur diçka disa herë sepse nuk kupton ndryshe, ose sepse çështja për të cilën debatojmë është e qartë dhe nuk nevojitet të paraqiten argumente [...]

Pyetja e dytë: Kjo sure hapet me një ligjërim të ashpër; etiketimi i tyre mohues, dhe mbyllet me një shprehje të zbutur dhe tolerante **“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time.”**, është e mundur të harmonizohen këto dy regjistra në dukje të kundërt?

Mund të them se përgjigjja e duhur do të ishte kjo: Vërtet unë ju kam qortuar ashpër për këtë gjë të shëmtuar, por në qoftë se nuk ju pëlqen qëndrim im atëherë më lini të qetë dhe kështu jemi barabar.

Pyetja e tretë: Përderisa përsëritja vjen si konfirmim i qëndrimit të tij do të ishte e arsyeshme të thoshte “unë nuk adhuroj kurrë çfarë adhuron”^[4] sepse kjo është formë e prerë dhe më e qartë, nuk e keni vënë re se edhe banorët e shpellës thanë **“Ne nuk do t’i lutemi kurrë asnjë zoti tjetër, përveç Tij”** el-Kehf:14^[5].

Edhe për këtë pyetje të fundit do të përgjigjesha kështu: Njeriu detyrohet ta intensifikojë përgjigjen në rast akuze, ama që të gjithë e dinin se Muhamedi kurrë nuk kishte adhuruar ndonjë idhull para profecisë, si mund ta bënte një gjë të tillë pas saj?! Ndërsa rasti i banorëve të shpellës është ndryshe, disa prej tyre kishin bërë gabime të tilla para se të njiheshin me të vërtetën.

“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”

Këtu do të trajtoj disa çështje:

Çështja e parë: Abdulla ibn Abasi e ka komentuar kështu këtë ajet: “Ju keni kufirin tuaj ndërsa unë teuhidin tim dhe sinqeritetin për Zotin.” Ky është edhe komenti i parë për këtë ajet.

Mund ta konsiderojmë këtë sjellje si konfirmim të kufirit të tyre? Sigurisht që jo, sepse në fakt profetit (a.s.) pikërisht ky mision iu ngarkua, pra të refuzojë kufirin, si mund ta lejonte ai një gjë të tillë?! Por përgjigjja në fjalë mendoj se ka një nga këto qëllime:

1. Kjo mund të jetë një formë kërcënimi, siç thotë Allahu në Kuran: **“Bëni ç’të doni ...!”** Fusilet:40.
2. Le të themi profeti (a.s.) në përgjigje të kërkesës së tyre ju thotë: mua më ka dërguar Zoti t’ju tregoj të vërtetën dhe rrugën e shpëtimit, në qoftë se refuzoni dhe nuk më ndiqni mua atëherë largohuni prej meje dhe mos kërkoni të bëhem politeist si ju.
3. **“Ju keni fenë tuaj”** vazhdoni ta ndiqni në qoftë se humbja ju pëlqen më shumë, **“ndërsa unë kam fenë time”** dhe nuk heq dorë prej saj.

Komenti i dytë: Ju keni hesapin tuaj ndërsa unë timin, pra feja në këtë rast merr kuptimin e hesapit, gjithësecili ka hesapet e veta.

Komenti i tretë: Ajeti në fjalë lë të kuptohet fjalën shpërblim, pra ju do të merrni shpërblimin e fesë suaj ndërsa unë do të marr shpërblimin e fesë sime, dhe në fakt atyre u mjafton shpërblimi i fesë së tyre si fatkeqësi dhe dënim, ashtu siç mjafton shpërblimi për fenë tënde si nderim dhe shpërblim.

Komenti i katërt: Feja vjen me kuptimin e dënimit. Allahu thotë në Kuran: **“Të mos ju pengojë kurrfarë mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut.”** el-Nur:2, ky ajet trajton çështjen e *hadit*^[6], pra ju do të dënoheni nga Zoti im, ashtu siç edhe ju pretendoni se zotat tuaj do të më dënojnë mua, por idhujt tuaj janë thjesht trupa të pajetë, si mund të frikësohem unë prej tyre, të njëjtën gjë nuk do të guxoja ta thoja për ju, sepse ju duhet të keni arsye të frikësoheni nga Zoti im, i Gjithëpushtetshmi i qiejve dhe tokës.

Komenti i pestë: Feja vjen me kuptimin e lutjes, lutjuni Allahut me sinqeritet, pra ju keni lutjen tuaj **“por lutja e jobesimtarëve është e kotë.”** el-Rrad:14, **“Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin.”** el-Fatir:14. Dhe do të ishte fat i madh në fakt të mbaronte me kaq, dhe të mos ju dëmtonin atë ditë, por Ditën e Gjykimit ata do të pajisen me gjuhë dhe do ta mohojnë adhurimin tuaj, ndërsa Zoti im **“u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë”** el-Shura:26, dhe thotë: **“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”** el-Gafir:60, **“i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.”** el-Bekare:186.

Komenti i gjashtë: Feja vjen me kuptimin e adhurimit. Pra ju keni traditën tuaj të paraardhësve tuaj dhe të djajve, ndërsa unë kam traditën time të engjëjve dhe profecisë, kshuqë çdo njëri prej nesh do të mbetet besnik i traditës së vet, derisa ju të takoheni me djajt dhe të përfundoni në zjarr, ndërsa unë me engjëjt dhe të shkoj në parajsë.

Çështja e dytë: Ajeti kuranor **“Ju keni fenë tuaj”** është shprehje kufizuese, pra ju keni fenë tuaj për veten tuaj jo për shoqërinë, ashtu siç kam unë fenë time për vete jo për shoqërinë, njëjtë si fjala e Allahut **“e askush nuk do t’i mbartë gjynahet e tjetrit, dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar”** el-Nexhm: 38-39.

Pra unë jam urdhëruar të përcjell shpalljen, ndërsa ju të zbatoni urdhërat dhe ta pranoni atë, kështu unë e përmbusha misionin dhe u lirova nga përgjegjësia. Ndërsa këmbëngulja juaj në kufër nuk më dëmton aspak.

(...)

Përktheu: Dorian Balliu

Shënime

[1] Zoti përdor në këtë ajet kuranor termin ?????? – *kafirun* që është shumësi i fjalës ?????- *kafir*. Ibn Faris thotë se gërmat ?-?-? / kaf-fa-ra kanë një rrënjë të përbashkët dhe tregojnë një kuptim, të

mbulosh a të mbështjellësh diçka. Në këtë kuptim bujku që mbjell arën quhet *kafir*, sepse ai mbulon farën me dhe, madje këtë gjë e tregon edhe Allahu në Kuran “**Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit**” Hadid:20. Në këtë ajet Zoti përdor termin *????- Kufar* që është një tjetër formë e shumësit – *???? kafir* dhe i referohet bujqëve. Në këtë kuptim *kufri*-mohimi është e kundërta e *imanit*-besimit, dhe emërtohet kështu sepse ai mbulon të vërtetën, edhe mosmirënjohja quhet *kufër* sepse mosmirënjohësi mohon të mirat që i ka bërë dikush, pra *kufri* në kontekstin e besimit është mosmirënjohja më e madhe. Në fakt përkthimi i fjalëpërfjalshëm i fjalës *el-kafirun* do të ishte qafir, por ne e dimë që kjo fjalë në gjuhën shqipe është e ngarkuar me konotacion negativ, sepse fjala qafir në Gjuhën Shqipe përdoret rëndom për një njeri të lig, a një njeri të keq e mosmirënjohës, ndërsa termi kuranor bën fjalë për një person që mohon të vërtetën a e refuzon atë, i cili jo domosdoshmërisht është i lig, sepse ai mund të jetë edhe një person me norma të larta morale edhe pse mohon të vërtetën. Përkthyesit e Kuranit në Gjuhën Shqipe këtë term e kanë përshtatur mosbesimtarët – Hasan Nahi, dhe jobesimtarët – Sherif Ahmedi. Edhe John Esposito kur i referohet këtij termi në Fjalorin e Oksfordit për Islamin thotë: “Qafir do të thotë jobesimtar”, pastaj bën një sqarim që shkon në logjikën e gjithë çfarë thashë më lart “... nënkupton një refuzim aktiv të shpalljes hyjnore”. Ndërsa në një vend tjetër po në të njëjtin fjalor termin *Kufër* e përshtat mosbesim, gjithashtu do të thotë mosmirënjohje, -thotë ai. Por përshtatja e këtij termi në shqip me atë kuptim shfaq një problem, sepse ne e dimë që Iblisi është qafir, por ai beson që fjalët e Zotit janë të vërteta, por nuk e pohon këtë fakt me fjalë dhe e kundërshton me vepra, pra ai nuk është pabesimtar, por mohues. Gjithsesi duke qenë se kjo fjalë përsëritet shumë herë në këtë shkrim ne do të përdorim termin mohues.

[2] Dijetarët e Gjuhës Arabe përdorin gjithmonë emrat Zejd dhe Amër sa herë që sjellin një shembull në ndonjë kategori gramatikore. Pra emri Zejd nuk është një person i caktuar, por përdoret për lehtësi shqiptimi. Thuhet se gjuhëtari i famshëm Thaleb ka thënë: “Dijetarët e Kuranit iu përkushtuan Kuranit dhe fituan, edhe dijetarët e hadithit iu përkushtuan hadithit dhe fituan, po ashtu dijetarët e fikhut fituan, ndërsa unë që u mora me Zejdin dhe Amrin ku do të përfundoj?!

[3] Medhhebi xheberi i atribuohet Xhad ibn Derhem, dhe termi *el-Xheberije* rrjedh nga fjala *?????? – el-Xhebër* në gjuhën arabe që do të thotë detyrim, imponim dhe shtrëngim, nga ky kuptimi gjuhësor merr kuptim teologjik termi në fjalë. Medhhebi xheberi konsideron se njeriu nuk është i lirë në zgjedhjet e tij, pra sipas këtij pohimi njeriu nuk zgjedh të besojë apo mohojë, sepse ai është i programuar, mes shkollave të shumta ky është qëndrimi më ekstrem në raport me *Kaderin* (paracaktimin e Zotit), është qëndrim fatalist sepse e konsideron njeriun pa vullnet dhe liri. Kjo doktrinë i hap rrugën keqbërjes dhe neglizhimit të detyrimeve ndaj Zotit, sepse justifikon veprimet e gabuara të njeriut me pretendimin se ai do ta vepronte patjetër atë që vepronte sepse ai nuk ka liri zgjedhje, edhe kur bëhet fjalë për neglizhimin e detyrimeve përdoret i njëjti justifikim, pra njeriu nuk e kreu X adhurim le të themi sepse ai është i programuar të mos e bëjë. Në thelb kjo doktrinë e shkatërron nga themelet Fenë Islame.

[4] Në këtë ajet kuranor është përdorur pjesëza mohuese ?? – *la* – nuk, jo, që është një pjesëz mohuese standarde dhe e thjeshtë, ndërsa autori në pyetjen e tretë sugjeron që pjesëza mohuese duhet të ishte ?? – *len* – kurrsesi, një pjesëz mohuese që shpreh mohim kategorik dhe të përjetshëm.

[5] Në këtë ajet Allahu përdor pjesëzën mohuese ?? – *len*.

[6] *el-Had* është një masë ndëshkimore e përcaktuar në sheriatin islam nga Zoti, ndryshe nga *taziri* që është një masë ndëshkimore e papërcaktuar, si e tillë është ekskluziviteti i ixtihadit të gjykatësit a të parit të shtetit, i cili përcakton masën ndëshkimore për një vepër të caktuar penale sipas rastit.

Date Created

06/06/2023

Author

erasmusi